



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-2596/14</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>11.07.2014</u>
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2040/14, për z. Besim Mehmeti – Ish Anëtar i Kuvendit Komunal të Gjakovës, për arsye se i njëjti, tashmë, ka mbaruar mandatin e Anëtarit të Kuvendit Komunal dhe ndërkohë nuk ushtron asnjë funksion tjetër publik, prandaj nuk ka konflikt interesi.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2040/14, për z. Besim Mehmeti – Ish Anëtar i Kuvendit Komunal të Gjakovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat D.P.H. RESTAURANT “KOSHARE”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ish zyrtarit të lartë z. Besim Mehmeti, së pari i është bërë shkresa njoftuese për njoftimin e fillimit të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së Konfliktit të Interesit nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë, me ç’ rast është kuptuar se tashmë nuk është zyrtar i lartë për shkak se i ka mbaruar funksioni i tij publik si Anëtar i Kuvendit Komunal të Gjakovës dhe nuk ka marrë ndonjë funksion tjetër si zyrtar i lartë.

Këtë e kemi konfirmuar me formularin për deklarimin e pasurisë, të cilin z. Mehmeti e ka dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsionit.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

